

Karta e-Dytë e apostollit Pa- vel mbë Thessallonikasitë.

Krye 1.

- 1 Pavli edhe Silluani edhe Timotheu, mbë kishën'e Tessallonikasvet, *që është* mbë Perëndinë, Atinë t'ënë, edhe mbë Zotinë Jisu Krisht; Hir *qoftë* mbë ju edhe paqtim nga Perëndia, Ati ynë, edhe nga Zoti Jisu Krisht.
- 3 Kemi detyrë t'i falemi ndersë përherë Perëndisë për ju, o vëllezër, sikundrë se vëjen, sepse po shtonetë fort besa juaj, edhe dashuria e kujdo prej jush mbë njëri tjetërinë
- 4 po tepëron; Kaqë sa ne vetë mburremi për ju ndë kishërat të Perëndisë, për durimnë t'uaj edhe për besënë ndër gjithë të-ndjekurat t'uaj edhe ndër shtrëngimet që hiqni;
- 5 *E-cila gjë është një* dëftim i gjyqit të-drejtë të Perëndisë, që të bëhi ju të-vëjejturë për mbretërin' e Perëndisë, për të-cilënë edhe vuan.
- 6 Sepse *është* e-drejtë përpara Perëndisë' t'u apë shtrëngim atyreve që u shtrëngonjënë
- 7 juve; Po juve që shtëngohi, të prëjturë bashkë me ne, kur të duketë Zoti Jisu Krisht prej qielli bashkë me ëngjëjt' e fuqis' së ti,
- 8 Ndë flakë zjarri, dyke bërë çpagim atyreve që nukë njohënë Perëndi, edhe atyreve që nuk' i bindenë ungjillit të Zotit t'ënë Jisu Krish; Të-cilëtë dotë mundonenë me të-prishurë të-

- 10 përjetëshm nga faqeja e Zotit, edhe nga lavdia e fuqis' s' ati, Kur të vinjë të lavduronetë ndër shënjtoret të ti, edhe të bënet' i-çudiçim ndër gjith'ata që besonjënë, (sepse ju i besuatë dëshmimit t'ënë,) nd' atë ditë.
- 11 Përandaj edhe *ne* falemi përherë për ju, që t'u bënjë juve Perëndia ynë të-vëjejturë për të-thëriturit' e ti, edhe të mbushnjë çdo pëlqim të mirësis' së ti, edhe punën' e besësë me
- 12 fuqij; Që të lavduronetë emëri i Zotit t'ënë Jisu Krisht ndër ju, edhe ju mb'atë, pas hirit të Perëndisë t'ënë edhe të Zotit Jisu Krisht.

Kre. 2.

- 1 Edhe sa për të-ardhurit' e Zotit t'ënë Jisu Krist, edhe për të-mbledhuritë t'ënë mb' atë,
- 2 u lutëmi juve, o vëllezër, Të mos tundi çpejt nga mëndja *juaj*, as të mos trumbullohi as prej fryme, as prej fjale, as prej karte sikurse *së-shkruarë* prej nesh, se sikur uafërua dit' 3 e Krishtit. Letë mos u gënjenjë juve ndonjë as me ndonjë mënyrë; sepse *s'ka për të ardhur'ajo ditë*, pa mos ardhurë më përpara të-ngrituritë krye, edhe të sbulonetë njeriu i fajit, i bir'i humbjesë, Ay që rri kundrë e ngrihetë lart kundrë çdo *farë gjëje* që thuhetë Perëndi a lutje, kaqë sa të rrijë ndë tempull të Perëndisë si Perëndi, dyke dëftyerë vetëhen'e ti se është Perëndi.
- 5 Nukë mbani mënt se, edhe kur ishnjam

- 6 përanë jush, u'a thoshnjam juve këto? Edhe ndashti e dini atë që e ndalon atë, që të
7 sbulonetë ndë kohët të ti. Sepse fshehësira e paudhësisë ndashti vepëronetë; vetëmë gjer-
sa te hiqetë nga mezi ay që e ndalon ndash-
8 ti; Edhe atëhere dotë sbulonetë i-paudhi, të-
cilinë Perëndia dot'a humbasnjë me frymën' e gojës' së ti, edhe dot'a prishnjë me të-dukur-
9 rit' e të-ardurit të ti; Ky *i-paudhë* dotë vinjë pas vepërimit të Satanajt me çdo fuqi e me
10 shënja e me çudira gënjeshtre, Edhe me çdo-
kobim të shtrëmbërisë, ndër mest t'atyre që humbenë; sepse nukë pritnë dashurin' e së-
11 vërtetësë që të shpëtonjënë. Edhe përandaj Perëndia dot'u dërgonjë atyre vepërim kobi-
12 mi, që t'i besonjënë gënjeshtësë; Qe të dëno-
nenë gith' ata që nuk' i besuanë së-vërtetësë, po pëlqyenë satëmbërinë.
- 13 Po neve kemi detyrë t'i falemi ndersë Pe-
rëndisë përherë për ju, o vëllezër të-dashurë prej Zotit, se Perëndia u sgjodhi juve që
ndë kryet për shpëtim me anë të shënjtëri-
mit të Frymësë, edhe me anë të besësë mbë
14 të-vërtetënë, Ndë të cilët u thirri juve me anë të ungjillit t'ënë, për të fituarë lavdin' e
Zotit t'ënë Jisu Krisht.
- 15 Përandaj pra, o vëllezër, qëndroni, edhe mbani ato porosi që umësuatë, a me anë
16 fjale, a me anë karte prej nesh. Edhe vetë Zoti ynë Jisu Krist, e Perëndia edhe Ati ynë'

i-cili na deshi e *na* dha ngushullim të-për-
jetëshëm edhe shpresë të-mirë me anë të hi-
17 rit, Ngushulloftë zëmëratë t'uaj e u forcof-
të mbë çdo fjalë e punë të-mirë.

Krye 3.

- 1 Mbë ndë funtt, o vëllezër, fali për ne
që të mbrothësonjë me të-çpejtë fjala e Zo-
tit edhe të lavduronetë, sikundrë edhe ndër
2 ju, Edhe që të spëtojmë nga njerëzit e-kotë
e të-liq; sepse besa nuk' është ndër të-gjithë.
3 Po Zoti është besnik, i-cili dot'u forconjë
4 juve e dot u ruanjë prej të-ligut. Edhe kemi
të-besuarë mbë ju me anë të Zotit, se ato
që u porositmë juve, edhe i bëni, edhe dot' i
5 bëni. Edhe Zoti drejtoftë zëmëratë t'uaj ndë
dashurit të Perëndisë, edhe ndë durimt të
Krishtit.
- 6 Edhe u porositimë juve, o vëllezër, mbë e-
mërë të Zotit t'ënë Jisu Krisht, të mërgohi
nga çdo vëlla që ecën pa ment, e jo pas poro-
7 sisë që mori prej nesh. Sepse juve e dini qysh
duhetë të bëni si bëjmë neve; sepse nuk' u
8 suallmë si të-marrë ndër ju, As dhurëti hën-
grëmë bukë prej ndonjëj, po me të-lodhur' e
me mundim, dyke punuarë nat' e ditë, që të
9 mos i bënëshimë barrë ndonjëj prej jush; Jo
se s'kemi pushtet, po që t'u apëmë juve ve-
tëhenë t'ënë për shëmbëllesë që të bëni si
10 bëjmë neve. Sepse edhe kur ishimë ndër ju

- këtë u porositnimë juve, se ndë mos do ndo-
11 një të punonjë, as të mos hajë. Sepse dëgjoj-
më se ca veta ndër ju ecënjënë jo si duhetë,
edhe se s' punonjë në fare, po sillen' andej e
këtej pa ndonjë punë, dyke umarrë me pu-
12 nëra të-huaj. Të-këtilletë i porositimë e i
ngutimë me anë të Zotit t' ënë Jisu Krisht, që
dyke punuarë me pushim të hanë bukën' e
tyre.
- 13 Po ju, o vëllezër, mos ulothni dyke bërë
14 mirë. Edhe ndë qoftë se ndonjë nukë i dë-
gjon fjalësë s'anë me anë të *kësaj* karte, shë-
no-e-ni atë; edhe mos shoqëroni me atë, që
15 të turpëronetë. Po mos e vështroni atë si ar-
mik, po këshillo-e-ni si vëlla.
- 16 Edhe vetë Zoti i paqtimit u dhëntë juve
paqtiminë kurdo me çdo mënyrë. Zoti *qoftë*
me ju të-gjithë.
- 17 Të-falluritë me shëndet *ushkrua* me do-
rënë t' ime, te Pavlit, që është shënjë mbë çdo
kartë; kështu shkruanj: Hiri i Zotit t' ënë Jisu
Krisht *qoftë* bashkë me ju të-gjithë. Amin.

